



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 103 Prot

Tiranë, më 16 . 01.2026

V E N D I M

Nr. 4 , datë 16 / 01 / 2026

“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Bashkisë Kolonjë dhe paralajmërimin e institucionit për rregullimin e ligjshmërisë, me qëllim përmirësimin e situatës”

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i ndryshuar, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me mbikëqyrjen e kryer në institucionin e Bashkisë Kolonjë,

VËREJ SE:

Me urdhrin nr. 94, datë 24.10.2025 “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, si dhe gjatë aplikimit të institutit të disiplinës në shërbimin civil, në Bashkinë Kolonjë”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka filluar mbikëqyrjen në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil, nëpërmjet pranimit në shërbimin civil; lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, si dhe gjatë aplikimit të institutit të disiplinës në shërbimin civil, duke vlerësuar respektimin e kërkesave të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, nga ana e subjekteve të ngarkuara prej ligjit me detyra specifike për administrimin e këtij procesi.

Procesi është zhvilluar në përputhje me Programin e Mbikëqyrjes nr. 886/1 prot., datë 24.10.2025, të miratuar nga Komisioneri, njoftuar Kryetarit të Bashkisë Kolonjë me shkresën nr. 886/2 prot., datë 24.10.2025 “Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në Bashkinë Kolonjë”.

Mënyra e administrimit të shërbimit civil në Bashkinë Kolonjë, si njësi e qeverisjes vendore, bazohet në nenin 2, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, ku është parashikuar në mënyrë të shprehur se, *“fusha e veprimit të tij shtrihet për çdo nëpunës që ushtron një funksion publik, në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur, apo njësi të qeverisjes vendore”*.

Në përfundim të procesit të verifikimit të dokumentacionit dhe grumbullimit të të dhënave, grupi i punës ka hartuar projektraportin për situatën e konstatuar, i cili i është dërguar për njohje subjektit të mbikëqyrur me shkresën nr. 886/3 prot., datë 24.12.2025, të Komisionerit, duke i lënë 10 ditë kohë për të paraqitur komentet e tyre në lidhje me konstatimet e evidentuara nga grupi i mbikëqyrjes. Ndërkohë, subjekti i mbikëqyrur, pasi është njohur me projektraportin dhe gjetjet e grupit të punës, e ka dërguar materialin pranë Komisionerit të nënshkruar, pa observacione, me shkresën e tyre nr. 75 prot., datë 07.01.2026 (*protokolluar pranë Komisionerit me nr. 40 prot., datë 09.01.2026*).

Gjatë procesit të mbikëqyrjes, Komisioneri vlerësoi si të rëndësishme, për të dhënë disa orientime në lidhje me procesin e ndërtimit të strukturës dhe organigramës së institucionit, për të siguruar aplikimin e standardeve më të mira në ndërtimin e skemës së administrimit të shërbimit civil në institucionin e mbikëqyrur, nëpërmjet një vlerësimi real të pozicioneve të punës që e përbëjnë aktualisht skemën e administrimit të shërbimit civil, në referencë të nenit 19 të ligjit për nëpunësin civil dhe akteve nënligjore që rregullojnë këtë aspekt, me qëllim që të përcaktohet me saktësi raporti i tyre me shërbimin civil, e për pasojë një strukturë eficiente dhe efektive.

E rëndësishme është të theksohet gadishmëria e institucionit, për të zbatuar detyrat e lëna nga Komisioneri, në drejtim të ngritjes së Komitetit të Vlerësimit të pozicioneve të shërbimit civil, si dhe për njoftimin e subjekteve që janë pjesë e procesit të rishikimit të përshkrimeve të punës. Aktet që materializojnë këto veprime janë administruar nga Komisioneri, por nga ana tjetër, ende nuk janë arritur rezultate konkrete për finalizimin e këtij procesi.

Për këtë arsye Komisioneri e vlerëson të rëndësishëm përfundimin e procesit të vlerësimit të pozicioneve të punës dhe më tej ndërtimin e strukturës sipas orientimeve konkrete që janë pasqyruar edhe në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.

Konstatohet se nga ana e institucionit, në përgjithësi, janë respektuar kërkesat e ligjit nr.152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmjet institutit të pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, ndërkohë që janë evidentuar edhe mangësi në drejtim të administrimit të shërbimit civil, të cilat janë vënë në dukje si konstatime në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, ndër të cilat:

- në 14 raste janë emëruar punonjës në pozicione pune të shërbimit civil, në kundërshtim me kërkesat dhe procedurat e ligjit, në pjesën që rregullon institutin e rekrutimit;

konstatohen parregullsi në veprimet administrative që duhet të kryhen gjatë aplikimit të institutit të periudhës së provës në 7 raste:

- a) rezulton se nuk është caktuar nëpunësi civil më i vjetër në detyrë dhe si rezultat mungon mendimi me shkrim i tij;
- b) mungon formulari i vlerësimit vjetor të punës, për nëpunësin civil në periudhë prove, i cili është një element i domosdoshëm për të vlerësuar me objektivitet punën e kryer nga nëpunësi gjatë kësaj periudhe, me qëllim konfirmimin ose jo të tij;
- c) Nuk konstatohet asnjë akt administrativ i eprorit drejtpërdrejt i cili konfirmon zgjatjen e periudhës së provës, për shkak të mospërfundimit me sukses të trajnimit të detyrueshëm në ASPA, rast ky i parashikuar në shkronjën "b", pika 7, të VKM nr. 243, dt. 18.3.2015.

Komisioneri vlerëson se, mangësitë e konstatuara gjatë mbikëqyrjes, duhet të rregullohen dhe njësia e burimeve njerëzore e institucionit, e cila e ushtron funksionin e saj në përputhje me të gjitha rregullat e përcaktuara në ligjin nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, gjatë veprimtarisë së saj, si dhe të gjithë nëpunësit e tjerë të angazhuar me detyra të administrimit të shërbimit civil, duhet të zbatojnë me korrektësi të gjitha kërkesat e ligjit për nëpunësin civil.

Sa më sipër, çmoj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij në lidhje me problematikat e evidentuara.

Në këto rrethana, pasi shqyrtova raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i punës, vlerësoj se duhet të miratoj përmbytjen e tij.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar; ligjit nr. 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*", si dhe Rregullores "*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i ndryshuar,

V E N D O S A:

- I. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave në administrimin e shërbimit civil, në institucionin e Bashkisë Kolonjë, i cili do të jetë pjesë e këtij vendimi dhe të paralajmëroj institucionin për të rregulluar situatën sipas detyrave që do të evidentohen në vijim.
- II. Për përmirësimin e situatës së administrimit të shërbimit civil, në lidhje me klasifikimin racional të pozicioneve të shërbimit civil në kategorinë dhe klasën e zbatueshme për secilën kategori, në përputhje me përcaktimet e nenit 19, të ligjit nr. 152/2023 "*Për nëpunësin*

civil". të ndryshuar, si dhe pikës 5, të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura", i ndryshuar, subjektet e ngarkuara prej ligjit, ndër të cilat Komiteti i Vlerësimit, analisti i punës, njësia përgjegjëse dhe eprorët direkt për pozicionet e vlerësuara, duhet të finalizojnë procesin e nisur për vlerësimin e pozicioneve të shërbimit civil, duke ndjekur procedurën, sipas orientimeve në përmbajtje të raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.

Vendimi përfundimtar i Komitetit të Vlerësimit dhe përshkrimet e rishikuara të punës, duhet të dërgohen pranë Komisionerit në përfundim të afatit të paralajmërimit

- III. Procesi i vlerësimit dhe klasifikimit të pozicioneve të punës i përfunduar, të pasqyrohet në aktin që shoqëron strukturën e paraqitur për miratim tek Kryetari i Bashkisë për vitin pasardhës, nga njësia përgjegjëse, ose grupi i ngarkuar me këtë detyrë (*relacion apo memo*) dhe të informohet Komisioneri për vendimmarrjen përfundimtare, duke i dërguar edhe aktin e miratimit të strukturës.
- IV. Pasi të përcaktohen në mënyrë përfundimtare pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, klasat e zbatueshme për secilën kategori, si dhe emërtesat e pozicioneve të punës që i përkasin secilës klasë, të rishikohet plani i rekrutimeve në shërbimin civil, duke përfshirë në këtë akt, të gjitha vendet vakante që kanë dalë nga procesi i vlerësimit. Në planin e rekrutimit, në përputhje me strukturën finale të institucionit, të përfshihen pozicionet e punës që janë efektivisht të lira, si dhe pozicionet e plotësuara në kundërshtim me ligjin, me emërim të përkohshëm, duke pasqyruar një planifikim të qartë të rekrutimit, ku të evidentohet përkatësisht, pozicioni i punës dhe afati konkret se kur do të realizohet konkurrimi për plotësimin e tij.
- V. Pasi të kryhen të gjitha detyrat që janë lënë në pikat II; III dhe IV të këtij vendimi, Kryetari i Bashkisë Kolonjë, të konstatojë pavlefshmërinë absolute të akteve të emërimit për punonjësit e emëruar në kundërshtim me ligjin, në pozicione pune që rregullohen nga ligji për nëpunësin civil dhe të rregullojë pasojat, duke i shpallur pozicionet e lira pranë AKPA-së, për tu plotësuar në përputhje me ligjin.

Bëhet fjalë për pozicionet e punës, të cilat aktualisht janë të zëna nga punonjës të emëruar përkohësisht, sipas akteve që do të evidentohen në vijim, të nxjerra në kundërshtim me ligjin:

1. **Arnold Fetallari**, emëruar me aktin nr. 469, datë 02.09.2024, të titullarit, në pozicionin "Specialist audit";
2. **Kledia Brame**, emëruar me aktin nr. 654 prot., datë 06.12.2024, të titullarit, në pozicionin "Specialist për Integrimin European";
3. **Enxhi Qirjazi**, emëruar me aktin nr. 553 prot., datë 14.10.2024, të titullarit, në pozicionin "Specialist për administrimin e aseteve";

4. **Laura Skënderas**, emëruar me aktin nr. 496, datë 18.09.2024, të titullarit, në pozicionin "Përgjegjës i sektorit të auditit" (më parë, me aktin nr. 23, dt.13.11.2023, është emëruar me procedurë konkurruese, "Specialist Audit");
5. **Origest Lifo**, emëruar me aktin nr. 609, datë 12.11.2024, të titullarit, në pozicionin "Drejtor i Çështjeve Juridike dhe Prokurimeve";
6. **Dorina Tallo**, emëruar me aktin nr. 651 prot., datë 06.12.2024, të titullarit, në pozicionin "Përgjegjës Sektori Juridik";
7. **Anxhela Kristo**, emëruar me aktin nr. 652 prot., datë 06.12.2024, të titullarit, në pozicionin "Përgjegjës për Prokurimet Publike" (më parë, me aktin nr. 4956, dt.19.10.2020, është emëruar me procedurë konkurruese, "Specialist GIS");
8. **Greta Asabella**, emëruar me aktin nr. 83, datë 25.02.2025, të titullarit, në pozicionin "Specialist finance";
9. **Erjona Isa**, emëruar me aktin nr. 382 prot., datë 04.08.2025, të titullarit, në pozicionin "Specialist tatim taksa";
10. **Enea Jorgji**, emëruar me aktin nr. 197 prot., datë 27.5.2025, të titullarit, në pozicionin "Drejtor i të Ardhurave e Tatim Taksave";
11. **Kleada Saliko**, emëruar me Urdhër nr. 219, datë 30.06.2025, të titullarit, në pozicionin "Specialist Finance";
12. **Sualdo Dino**, emëruar me aktin nr. 414, datë 28.8.2025, të titullarit, në pozicionin "Specialist i Zhvillimit Ekonomik";
13. **Eni Duro**, emëruar me aktin nr. 190 prot., datë 26.05.2025, të titullarit, në pozicionin "Drejtor i Artit Kulturës Sportit"; (më parë, me aktin nr 25 datë 13.11.2023 , është emëruar me procedurë konkurruese, "Specialist Finance në Dr. Artit Kulturës dhe Sportit");
14. **Brikena Ali**, emëruar me aktin nr. 197 prot., datë 27.05.2025, të titullarit, në pozicionin "Drejtor i Shërbimeve Publike";

Në momentin e shpalljes së pozicionit të lirë të punës, për tu plotësuar nëpërmjet konkurrimit, pozicioni duhet të jetë efektivisht i lirë, për të respektuar në këtë mënyrë parimet e pranimin në shërbimin civil, ndër të cilat parimi i shanseve të barabarta dhe profesionalizmit. Ky veprim do të rivendosë situatën e ligjshmërisë dhe do të mundësojë procesin e rekrutimit sipas kërkesave specifike që rregullojnë këtë institut të ligjit.

Njësia përgjegjëse e institucionit, të hartojë njw plan veprimi, i cili duhet të miratohet nga Kryetari i Bashkisë, ku të përcaktohen qartë: a) veprimet administrative që do të kryhen në zbatim të detyrave të lëna sa më sipër; b) subjekti/nëpunësi përgjegjës për kryerjen e veprimit, si dhe c) afati/data brenda të cilës do të përfundojë kryerja e veprimit administrativ. Në këtë rast do të parashikohet edhe radha e kryerjes së konkurremeve për pozicionet e punës të cilat aktualisht janë të plotësuara në kundërshtim me ligjin, si dhe pozicionet të cilat rezultojnë të lira.

Plani i veprimit do të dërgohet pranë Komisionerit 2 muaj pas marrjes dijeni për vendimin paralajmërues të Komisionerit.

VI. Njësia përgjegjëse e institucionit, të anullopë aktet e konfirmimit për nëpunësit në periudhë prove sipas orientimeve të dhëna në Raportin përfundimtar dhe të rregullojë procesin

nëpërmjet akteve të reja administrative, në përputhje me legjislacionin për shërbimin civil, për rastet si më poshtë:

1. **Elson Guce**, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 77 prot., datë 30.12.2022, të Burimeve Njerëzore, në pozicionin “*Specialist për Emergjencat Civile*”, në Drejtorinë e Mbrojtjes Civile, konfirmuar me aktin nr. 5552 Prot., datë 25.11.2024
 2. **Kristjan Lalollari**, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 59 prot., datë 17.02.2022, të Burimeve Njerëzore, në pozicionin “*Specialist për shërbimet publike*”, në Sektorin e shërbimeve digjitale, konfirmuar me aktin nr. 5553 Prot., datë 25.11.2024
 3. **Eltona Josifi**, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 149 prot., datë 29.03.2022, të Burimeve Njerëzore, në pozicionin “*Specialist finance*”, në Sektorin e Buxhetit, konfirmuar me aktin nr. 5555 Prot., datë 25.11.2024.
 4. **Diljola Meko**, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 26 prot., datë 13.11.2023, të Burimeve Njerëzore, në pozicionin “*Specialist Kontabilist*”, në Sektorin e Financës, konfirmuar me aktin nr. 5560 Prot., datë 25.11.2024.
 5. **Ledjana Bendo**, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 59 prot., datë 30.09.2022, të Burimeve Njerëzore, në pozicionin “*Specialist për menaxhimin Pronave Publike*”, në Sektorin e Projekttimeve, Zhvillimit dhe Lejeve, konfirmuar me aktin nr. 5557 Prot., datë 25.11.2024.
 6. **Xhensila Kalemaj**, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 56 prot., datë 30.09.2022, të Burimeve Njerëzore, në pozicionin “*Specialist i Integritetit European*”, në Sektorin e Integritetit European, konfirmuar me aktin nr. 5556 Prot., datë 25.11.2024.
 7. **Pavlina Tafil**, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 4955, datë 19.10.2020, në pozicionin “*Specialist Turizmi*”, të Burimeve Njerëzore, në Sektorin e Zhvillimit të Turizmit, konfirmuar me aktin nr. 5554 Prot., datë 25.11.2024.
- Njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore duhet të administrojë në dosjen personale të secilit nëpunës aktet që provojnë plotësimin e të gjithë elementëve proceduralë të përcaktuar në nenin 24, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, si dhe kreut VI “*Periudha e provës*”, të VKM nr. 243, datë 18.3.2015 “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”, i ndryshuar, që janë:
 - Shkresa e eprorit direkt për caktimin e nëpunësit më të vjetër, nën kujdesin e të cilit është vendosur nëpunësi civil në periudhë prove si dhe mendimi me shkrim i tij në lidhje me performancën që ka treguar nëpunësi gjatë periudhës së provës.
 - Vendimi i eprorit direkt për zgjatjen një herë të vetme deri në 6 (*gjashtë*) muaj të periudhës së provës, për shkak të mospërfundimit me sukses të trajnimit të detyrueshëm në ASPA, rast ky i parashikuar në shkronjën “b”, pika 7, të VKM nr. 243, dt. 18.3.2015.
 - Certifikata e përfundimit me sukses të trajnimit të detyrueshëm pranë ASPA-s.

- Vlerësimi i rezultateve në punë për periudhën e provës, i cili bëhet sipas procedurave të përcaktuara në VKM nr. 109, dt. 26.2.2014, i ndryshuar. Në rastin e vlerësimit për periudhën e provës, periudha e vlerësimit fillon nga data e aktit të emërimit dhe zgjat deri në përfundim të periudhës së provës. Për këtë arsye, në formularin e vlerësimit të punës, në “Ndarja A”, duhet të përzgjidhet rasti “Tjetër (specifiko)”, duke shënuar “Vlerësim i rezultateve në punë për periudhën e provës”. Në këtë rast, zyrtarët e vlerësimit, krahas vlerësimit me notë në çdo rubrikë të formularit të vlerësimit, duhet të plotësojnë edhe ndarjen e dedikuar për komente dhe shpjegime.
- Vendimi i eprorit direkt në përfundim të periudhës së provës për konfirmimin apo moskonfirmimin e nëpunësit (ky vendim duhet t’i njoftohet nëpunësit dhe njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore).
- Akti i nxjerrë nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore për deklarimin e statusit të nëpunësit, në rastin e vendimit të konfirmimit, duhet të jetë sipas përcaktimeve të pikës 13, të kreut VI, të VKM nr. 243, dt. 18.3.2018, i ndryshuar.

VII. Të anulohet akti nr. 2050, datë 02.5.2024, i njësisë së burimeve njerëzore, për emërimin e nëpunëses **Elfaneada Dake** në pozicionin “Drejtor i Drejtorisë së Shërbimit Social”, pasi është nxjerrë në kundërshtim me legjislacionin për nëpunësin civil dhe në bazë të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, neni 109, germa “d” dhe nenin 113, i këtij ligji; pozicioni i punës të plotësohet sipas përcaktimeve të ligjit për shërbimin civil.

VIII. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **4 (katër) muaj** nga marrja dijeni për këtë vendim. Institucioni i mbikëqyrur dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim, duke u bazuar në orientimet e dhëna në raportin përfundimtar.

Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi, duke dërguar edhe aktet që vërtetojnë zbatimin e detyrave të lëna.

IX. Për këtë vendim të njoftohet Kryetari i Bashkisë Kolonjë, Prefekti i Qarkut Kolonjë, Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor dhe Agjensia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore.

Njësia Përgjegjëse e Bashkisë Kolonjë, duhet të njoftojë për këtë vendim, çdo punonjës që është i emëruar në kundërshtim me ligjin si dhe çdo subjekt tjetër i cili është ngarkuar me detyra të posaçme në raportin përfundimtar dhe në pjesën arsyetuese të këtij vendimi.

X. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, nga subjektet përkatëse, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të

ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Lefter Lleshi (Luzi)

